

Golat shqiptare ne Europe vijne nga pika e bardhe

nga Albaniassocer

E martë, 28 Tetor 2014 23:03



Ne ndeshjet e zhvilluara sonte ne darke kane shenuar 2 lojtare shqiptare. Ne serine b italiane eshte rikthyer tek fushat e blerta mesfushori Ledian Memushaj dhe e ka bere duke shenuar. Ne ndeshjen midis Barit vendas dhe Peskares vlonjati shenoi nga pika e bardhe e penalltise ne minuten 31. Ky gol i vlejti nje pike miqve abruceze. Me ane te penalltise shenoi edhe shkodrani Armando Vajushi ne ndeshjen e kupes se Bullgarise. Ndeshja midis Litex dhe Pirin Delchev perfundoi 3-1 dhe Vajushi shenoi penalltine ne minuten 85.